



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministarstvo za Rad i Socijalne Zaštite
Ministry of Labour and Social Welfare



AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
AGENCIJA ZA ZAPOSŁJAVANJE REPUBLIKE KOSOVA
EMPLOYMENT AGENCY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

vhs
DVV International

RAPORT I HULUMTIMIT

VLERËSIMI I PRAKTIKAVE TË REALIZIMIT TË PROGRAMEVE PËR TË RRITUR NË KUADËR TË QENDRAVE TË AFTËSIMIT PROFESIONAL

Prishtinë, 2017

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	1
LISTA E FIGURAVE.....	3
LISTA E TABELAVE.....	4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	5
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT.....	7
QENDRAT E AFTËSIMIT PROFESIONAL NË KOSOVË	9
Intervistimi i Kandidatëve të përzgjedhur që janë trajnuar në periudhën 2014- 2016	9
QAP PRISHTINA.....	12
QAP PRIZREN	16
QAP MITROVICA	20
QAP GJILANI.....	25
QAP PEJA	29
QAP FERIZAJ.....	34
QAP GJAKOVA.....	39
KONKLuzionet dhe Rekomandimet	44
SHTOJCA 1: KOMENTET E TË ANKETUARVE (RESPONDENTËVE).....	45
QAP PRISHTINA.....	45
QAP GJILANI.....	47
QAP MITROVICA	49
QAP PEJA	53
QAP PRIZRENI	57
QAP FERIZAJ.....	60
QAP GJAKOVA.....	64

LISTA E FIGURAVE

Figura 1 Të dhënat për punësimin e kandidatëve e trajnuar në QAP për vitet 2014-2016 sipas profesioneve	9
Figura 2 Të dhënat për punësimin e kandidatëve e trajnuar në QAP për vitet 2014-2016.....	10
Figura 3 Të dhënat për punësimin kandidatët e trajnuar në QAP Prishtinë	13
Figura 4 Mosha dhe shkollimi i kandidatëve të anketuar në QAP Prishtinë	13
Figura 5 Përgjigjet në pyetjen 4 se sa e vlerësoni aftësimin në të cilin keni marrë pjesë në QAP në Prishtinë	13
Figura 6 Përgjigjet në pyetjen 5 A mendoni që programi i aftësimit në QAP ju ka përgatitur për punë	14
Figura 7 Përgjigjet në pyetjen 6 A mendoni që pako e aftësimit dhe materialet.....	14
Figura 8 Përgjigjet në pyetjen 7 A mendoni që trajnerët kanë përgatitje të duhur profesionale	14
Figura 9 Përgjigjet në pyetjen 8 A janë arritur pritjet tuaja nga Aftësimi Profesional në QAP.....	15
Figura 10 Të dhënat për punësimin kandidatët e trajnuar në QAP Prizren	17
Figura 11.....	17
Figura 12.....	17
Figura 13 Përgjigjet në pyetjen 4 se sa e vlerësoni aftësimin në të cilin keni marrë pjesë në QAP në Prizren	18
Figura 14 Përgjigjet në pyetjen 5 A mendoni që programi i aftësimit në QAP ju ka përgatitur për punë	18
Figura 15 Përgjigjet në pyetjen 6 A mendoni që pako e aftësimit dhe materialet.....	18
Figura 16 Përgjigjet në pyetjen 7 A mendoni që trajnerët kanë përgatitje të duhur profesionale ..	19
Figura 18 Të dhënat për punësimin kandidatët e trajnuar në QAP Mitrovicë.....	21
Figura 22 Përgjigjet në pyetjen 5 A mendoni që programi i aftësimit në QAP ju ka përgatitur për punë	22
Figura 23 Përgjigjet në pyetjen 6 A mendoni që pako e aftësimit dhe materialet.....	22
Figura 24 Përgjigjet në pyetjen 7 A mendoni që trajnerët kanë përgatitje të duhur profesionale ..	23
Figura 25 Përgjigjet në pyetjen 8 A janë arritur pritjet tuaja nga Aftësimi Profesional në QAP.....	23
Figura 26 Të dhënat për punësimin kandidatët e trajnuar në QAP Gjilan	26
Figura 27.....	26
Figura 28.....	26
Figura 29 Përgjigjet në pyetjen 4 se sa e vlerësoni aftësimin në të cilin keni marrë pjesë në QAP në Gjilan	27
Figura 30 Përgjigjet në pyetjen 5 A mendoni që programi i aftësimit në QAP ju ka përgatitur për punë	27
Figura 31 Përgjigjet në pyetjen 6 A mendoni që pako e aftësimit dhe materialet.....	27
Figura 32 Përgjigjet në pyetjen 7 A mendoni që trajnerët kanë përgatitje të duhur profesionale ...	28
Figura 33 Përgjigjet në pyetjen 8 A janë arritur pritjet tuaja nga Aftësimi Profesional në QAP.....	28
Figura 34 Të dhënat për punësimin kandidatët e trajnuar në QAP Pejë	30
Figura 35.....	30
Figura 36.....	31
Figura 37 Përgjigjet në pyetjen 4 se sa e vlerësoni aftësimin në të cilin keni marrë pjesë në QAP në Pejë.....	31
Figura 38 Përgjigjet në pyetjen 5 A mendoni që programi i aftësimit në QAP ju ka përgatitur për punë	31
Figura 39 Përgjigjet në pyetjen 6 A mendoni që pako e aftësimit dhe materialet.....	32
Figura 40 Përgjigjet në pyetjen 7 A mendoni që trajnerët kanë përgatitje të duhur profesionale ..	32

Figura 41 Përgjigjet në pyetjen 8 A janë arritur pritjet tuaja nga Aftësimi Profesional në QAP	32
Figura 42 Të dhënat për punësimin kandidatët e trajnuar në QAP Ferizaj	35
Figura 43	35
Figura 44	36
Figura 45 Përgjigjet në pyetjen 4 se sa e vlerësoni aftësimin në të cilin keni marrë pjesë në QAP në Ferizaj	36
Figura 46 Përgjigjet në pyetjen 5 A mendoni që programi i aftësimin në QAP ju ka përgatitur për punë	36
Figura 47 Përgjigjet në pyetjen 6 A mendoni që pako e aftësimin dhe materialet	37
Figura 48 Përgjigjet në pyetjen 7 A mendoni që trajnerët kanë përgatitje të duhur profesionale ..	37
Figura 49 Përgjigjet në pyetjen 8 A janë arritur pritjet tuaja nga Aftësimi Profesional në QAP	37
Figura 50 Të dhënat për punësimin kandidatët e trajnuar në QAP Gjakovë	40
Figura 51	40
Figura 52	40
Figura 53 Përgjigjet në pyetjen 4 se sa e vlerësoni aftësimin në të cilin keni marrë pjesë në QAP në Gjakovë	41
Figura 54 Përgjigjet në pyetjen 5 A mendoni që programi i aftësimin në QAP ju ka përgatitur për punë	41
Figura 55 Përgjigjet në pyetjen 6 A mendoni që pako e aftësimin dhe materialet	41
Figura 56 Përgjigjet në pyetjen 7 A mendoni që trajnerët kanë përgatitje të duhur profesionale ..	42
Figura 57 Përgjigjet në pyetjen 8 A janë arritur pritjet tuaja nga Aftësimi Profesional në QAP	42

LISTA E TABELAVE

Tabela 1 Të dhënat për Profesione të ofruara nga QAP në periudhën 2014-2016	9
Tabela 2 Të dhënat përmbledhëse për moshën dhe shkollimin e kandidatëve të trajnuar në QAP 2014-2016	11
Tabela 3 Të dhënat për Profesione të ofruara nga QAP në Prishtinë periudhën 2014-2016	12
Tabela 4 Moshë dhe shkollimi kandidatëve të trajnuar në QAP në Prishtinë 2014-2016	12
Tabela 5 Të dhënat për Profesione të ofruara nga QAP në Prizren periudhën 2014-2016	16
Tabela 6 Moshë dhe shkollimi kandidatëve të trajnuar në QAP në Prizren 2014-2016	17
Tabela 7 Të dhënat për Profesione të ofruara nga QAP në Mitrovicë periudhën 2014-2016	20
Tabela 8 Moshë dhe shkollimi kandidatëve të trajnuar në QAP në Mitrovicë 2014-2016	20
Tabela 9 Të dhënat për Profesione të ofruara nga QAP në Gjiilan periudhën 2014-2016	25
Tabela 10 Moshë dhe shkollimi kandidatëve të trajnuar në QAP në Gjiilan 2014-2016	25
Tabela 11 Të dhënat për Profesione të ofruara nga QAP në Pejë periudhën 2014-2016	29
Tabela 12 Moshë dhe shkollimi kandidatëve të trajnuar në QAP në Pejë 2014-2016	30
Tabela 13 Të dhënat për Profesione të ofruara nga QAP në Prishtinë periudhën 2014-2016	34
Tabela 14 Moshë dhe shkollimi kandidatëve të trajnuar në QAP në Ferizaj 2014-2016	35
Tabela 15 Të dhënat për Profesione të ofruara nga QAP në Gjakovë periudhën 2014-2016	39
Tabela 16 Moshë dhe shkollimi kandidatëve të trajnuar në QAP në Gjakovë 2014-2016	39

Hartues të raportit: Merita Mehmetaj dhe Ramë Likaj

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), respektivisht Departamenti i Punës dhe i Punësimit, qysh prej vitit 2000 ka themeluar 8 Qendrat Aftësimit Profesional (QAP) në 7 regjionet e Kosovës, me qëllim të zbutjes së papunësisë në Kosovë, duke ofruar trajnim profesional dhe certifikim falas për personat të cilët janë të evidentuar si të papunë nëpër Qendrat Regjionale të Punësimit.

Në vitin 2014, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Ligjin Nr. 04/L-205 për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës. Më 5 prill 2017, është funksionalizuar kjo agjenci në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe menaxhon me QAP dhe zyrat e punësimit. Sipas këtij ligji¹, Qendrat e Aftësimit Profesional kanë në përgjegjësi:

- Ofrimi i shërbimeve të aftësimit profesional, që kërkohen nga tregu i punës;
- Vlerësimi dhe Certifikimi i kandidateve; njohja e mësimit paraprak;
- Monitorimi i ofruesve tjerë të trajnimit që zhvillojnë trajnime me marrëveshje me agjencinë, vlerësimi dhe certifikimi i kandidatëve;
- Përgatitja e Planin Individual të Trajnimit për kandidat që kryejnë punë praktike në kompani si dhe monitorimi, vlerësimi dhe certifikimi;
- Përgatitja e informatave për ecurinë e trajnimeve; dhe
- Kryen punë dhe detyra tjera të përcaktuara me akte tjera ligjore dhe nënligjore përkatëse.

Në vitin 2010 është hartuar një raport i hulumtimit për të vlerësuar efektin e trajnimeve (aftësimeve) profesionale në punësimin e të trajnuarve nga këto Qendra të Aftësimit Profesional. Ndërsa, ky është raporti i dytë me radhë që e trajton këtë problematikë, duke u bazuar në të dhënat e hulumtimit të zhvilluar me përkrahje të DVV International.

Qëllimi i hulumtimit ishte identifikimi i shkallës së punësimit për personat të cilët kanë kryer trajnimet në profesionet e ndryshme gjatë tri viteve 2014-2016, të cilat ofrohen nga 7 Qendrat e Aftësimit Profesional në; Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Pejë, Gjakovë, Prizren dhe Mitrovicë, gjithashtu nga ky anketim të nxjerrim informacione tjera të rëndësishme që do të shërbejnë si tregues dhe matës i performances së QAP për nivelin e ofrimit të shërbimeve të trajnimit.

Bazuar në të dhënat e fituara nga anketimi shihet se përqindjet e kandidatëve të punësuar që kanë qenë pjesë e aftësimeve profesionale gjatë periudhës 2014-2016 është si në vijim: QAP Mitrovicë 82.8%, QAP 75.3%, QAP Prizren 71.8%, QAP Gjakovë 61.5%, QAP Gjilan 45.7%, QAP Prishtinë 38.5% dhe QAP Pejë me 36.8%. Tabela krahasuese për punësimin sipas QAP në dy periudha 2014-2016 me 603 respondentë dhe anketimin e kryer me 2011 për periudhën 2008-2010 me 687 respondentë. Nga ky krahasim shihet që trendi i rezultateve të punësueshmërisë është afërsisht i njëjtë për QAP në Prishtinë, QAP Gjilan por me një rënje shumë të vogël, ndërsa rritje shumë të mëdha janë shënuar në QAP Mitrovicë me mbi 30%, rritje me rreth 10% të punësimit të kandidatëve të trajnuar është shënuar në QAP Prizren, QAP Gjakovë, si dhe kemi një rënie me 7.3% në QAP në Ferizaj.

¹ Gazeta Zyrtare, (2014), Ligji Nr. 04/L-205 për Agjencinë e Punësimit në Republikën e Kosovës, Neni 8, Detyrat dhe përgjegjësitë e Qendrave të Aftësimit Profesional, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8983>.

Tabela krahasuese e dy periudhave 2014-2016 dhe 2008-2010²

QAP	Kandidatët që punojnë %	
	2014-2016	2008-2010
QAP Prishtinë	38,5	40
QAP Prizren	71,8	61
QAP Mitrovicë	82,8	49
QAP Gjilan	45,7	50
QAP Pejë	36,8	48
QAP Ferizaj	75,3	82
QAP Gjakovë	61,5	53

Struktura gjinore e kandidatëve të anketuar prej mostrës prej 603 është 67.8% janë meshkuj, ndërsa vetëm 32.2% femra. Ndërsa nga rezultati i përgjithshëm i të punësuarve të kandidatëve të anketuar prej 66.2%, prej tyre përqindja e kandidateve femra të punësuar është vetëm 22.1%.

Të gjithë kandidatët e anketuar janë të certifikuar dhe kanë ndjekur 1 deri në 10 module të aftësimi profesional. Të dhënat e anketimit tregojnë se kandidatët janë shumë të kënaqur me kushtet e përgjithshme, programin, kompetencat e trajnerit dhe pakot mësimore që ofrohen nga QAP, megjithatë disa profesione kanë rezultate më të ulëta të punësimit, ose mund të supozojmë se disa prej kandidatëve të anketuar hezitojnë të tregojnë që punojnë. Si do që të jetë Agjencia e Punësimit në vitin 2017 ka zhvilluar disa Standarde të Profesionit, kualifikimet profesionale konform këtyre standardeve dhe pakot mësimore dhe me siguri se ky trend për disa profesione të caktuara do të vazhdoj.

Shumica e kandidatëve e shohin si masë stimuluese për të ndjekur trajnimet në QAP sigurimin e transportit dhe një shujte, mirëpo ka edhe kërkesa që QAP të kenë lidhje me biznese lokale dhe që tu mundësohet punë praktike në këto biznese, ndërsa në disa raste kërkohet edhe një formë kompensimi për ta nëse ju ofrohet kjo mundësi. Në disa raste të anketuarit ankohen për hapësirat e vogla në punëtori, për materiale shpenzuese të pa mjaftueshme, teknologji të vjetër si dhe kërkojnë përditësimin e programeve të aftësimi dhe pakove mësimore. Gjithashtu, ata sugjerojnë të bëhet më tepër në informimin e të papunëve për profesionet, modulet e aftësimeve dhe mundësisë që ofrojnë QAP, si dhe në disa raste kanë kërkesa për shtimin e numrit të moduleve, hapjen e profesioneve të reja por edhe zgjatjen e orarit ditor të trajnimit.

Gjithashtu rezultatet e anketimit tregojnë se shumica e të anketuarve vijnë ose e kanë shkollimit paraprak me **41.6% me AAP dhe Arsim të lartë 32.2%**, që tregon me performancën e dobët të sistemit të arsimit. Moshë e pjesëmarrësve në aftësime profesionale është si në vijim 36.7% (16-25 vjeç), 32.8 (26-35 vjeç) dhe 30.5% mbi 35 vjeç.

² Tabela krahasuese për punësimin sipas QAP në dy periudha 2014-2016 me 603 respondentë dhe anketimin e kryer me 2011 për periudhën 2008-2010 me 687 respondentë.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Anketimi i kandidatëve të trajnuar në Qendrat e Aftësimeve Profesionale (QAP) të cilat e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në kuadër të Agjencisë së punësimit të Kosovës është zhvilluar nëpërmjet pyetësorit, i cili është hartuar posaçërisht për këtë hulumtim nga kompania nga ekspertët e DVV International dhe është aprovuar nga Agjencia për e punësimit. Me anë të kësaj ankete kemi mbledhur të dhënat të rëndësishme statistikore dhe mendime e komente të ndryshme përcjellëse për personat të cilët kanë përfunduar trajnimet gjatë viteve 2014-2016. Këto të dhëna të mbledhura krijojnë mundësi për të bërë vlerësime, analiza krahasuese midis profesioneve të ofruara në kuadër të QAP, por edhe ndërmjet vetë QAP, për periudhën trevjeçare 2014, 2015 dhe 2016, mbi punësueshmërinë e të trajnuarve sipas profesioneve përkatëse, strukturën gjinore, shkollimin, moshën etj, por edhe përshtatshmërinë e programeve të aftësimit, pakove mësimore dhe performancën e trajnerëve dhe kushtet e përgjithshme të ofruara në kuadër të QAP.

Pyetësori është dizajnuar ashtu që të sigurojë informacione të përgjithshme dhe specifike rreth vlerësimit të praktikave të realizimit të programeve për të rritur në Qendrat e aftësimit Profesional për periudhën 2014-2016.

Pyetësori përmban gjithsej 11 pyetje dhe është i ndarë në tri pjesë:

- I. Pjesa e parë, përmban informata të përgjithshme për kandidatët e trajnuar, përfshirë të dhënat personale (emrin, mbiemrin, moshën, gjininë), statusin e punësimit aktual, shkollimin paraprak të vijuesit të trajnimit dhe modulet e ndjekura profesionale në QAP.
- II. Pjesa e dytë, përmban informata lidhur me trajnimin e ndjekur nga kandidatët, përshtatshmërinë e trajnimeve profesionale për ngritjen profesionale të kandidatëve, në aspektin e kompetencave të nevojshme për tregun e punës, pakot dhe materialet mësimore, performancën dhe kompetencat e trajnerëve dhe pritjen e përgjithshme të kandidatëve nga trajnimet e ofruara në kuadër të QAP.
- III. Pjesa e tretë, përmban informata të bazuara në komentet dhe mendimet e kandidatëve për fushat në të cilat mendojnë se duhet të ketë ndryshime apo avansime në kuadër të ofertës së QAP, faktorët apo kushtet që do t'ju lehtësonin dhe do ti motivonin kandidatët të ndjekin trajnimet e ofruara në kuadër të QAP, si dhe komente dhe sugjerime tjera të cilat janë pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në këtë raport, por edhe veç e veç për secilën QAP në anekset e këtij raporti.

Pyetëtorët u janë shpërndarë Drejtorëve të QAP, në Koordinim të Plotë me menaxherët e Agjencisë së Punësimit. Drejtorët e QAP kanë pas për obligim të menaxhojnë në tërësi procesin e grumbullimit të dhënave dhe sjelljen e pyetësorëve në Agjenci. Vlen të theksohet se ekipi i ekspertëve të DVV International është takuar në QAP respektive dhe ju ka dhënë udhëzime përkatëse të gjithë Drejtorëve të QAP.

Hulumtimi është zbatuar dhe menaxhuar nga DVV International, zyra në Kosovë në bashkëpunim të ngushtë me MPMS , përkatësisht Agjencionin e Punësimit dhe QAP. Për këtë hulumtim është paraparë që të intervistohen së paku 5% e kandidatëve të përfshirë në programet e trajnimeve profesionale për secilën QAP, duke e plotësuar pyetëtorin e përgatitur nga MPMS dhe ARrK (DVV International). Përcaktimi i listës me kandidatë për intervistim është përgatitur nga Agjencia e Punësimit në bashkëpunim me QAP, të cilët edhe e kanë menaxhuar procesin e grumbullimit të pyetësorëve. Në këto lista janë përzgjedhur kandidatët nga të gjitha profesionet që ofrohen në QAP, duke i përzgjedhur nga baza e të dhënave për tri vite 2014-2016.

Pasi që një numër i kandidatëve të përzgjedhur nuk janë përgjigjur ftesës për mbushjen e pyetësorit për shkaqe nga më të ndryshme (ndërrimi i numrit kontaktues te telefonit, largësia e personit nga qendra, deklarimi i familjarëve se personi është punësuar jashtë dhe për shkaqe tjera), numri i pyetësorëve të plotësuar nuk është aq i madh dhe të gjeturat nga rezultatet e anketimit është vështirë të tregojnë gjendjen reale. Plotësimi i pyetësorit nga vet kandidatët është bërë në ambientet e QAP, ndërsa i tërë procesi është menaxhuar nga Drejtorët e QAP.

QENDRAT E AFTËSIMIT PROFESIONAL NË KOSOVË

INTERVISTIMI I KANDIDATËVE TË PËRZGJEDHUR QË JANË TRAJNUAR NË PERIUdhËN 2014- 2016

Në shtatë QAP është zhvilluar anketimi i kandidatëve që kanë zhvilluar trajnimet profesionale në ndonjërin nga profesionet që zhvillohen atje. Përzgjedhja e kandidatëve është bërë nga vetë stafi i QAP dhe qëllimi i këtij hulumtimi ishte identifikimi i shkallës së punësimit për personat të cilët kanë kryer trajnimet në profesionet e ndryshme gjatë tri viteve 2014-2016, të cilat ofrohen nga 7 Qendrat e Aftësisimit Profesional në; Prishtinë , Ferizaj, Gjilan, Pejë, Gjakovë, Prizren dhe Mitrovicë, gjithashtu nga ky intervistim të nxjerrim informacione tjera të rëndësishme që do të shërbejnë si tregues dhe matës i përformances së QAP për nivelin e ofrimit të shërbimeve të trajnimit.

Për të bërë një vlerësim për sa i përket profesioneve të caktuara është vështirë të nxjerrim ndonjë përfundim sepse mostrat e pranuar janë shumë të vogla, ndërsa për disa profesione që kanë numrin e mostrave më të madh ose që ofrohen në më shumë se një QAP atëherë rezultatet disa prej tyre kanë rezultate shumë të mira të dhëna në tabelën 1 p.sh. Rrobaqepësia 100%, Instaluesi i ngrohjes qëndrore 100%, Hoteleria 91.7%, Vetpunësimi 94.4%, Menaxhues i NVM 85.7%, Kamarier 76.5%, Floktaria 75%, Autoelektrika 71.4%, Kuzhinieri 68.5%, Agrokultura 66.7%, Saldimi 64.2%, Ndërmarrësi 62.5%, Zdukhtari 60%, Asistent Administrativ 58.6%, Kontabilitet 57.7%, ndërsa për profesionet siç janë: Dizajni Grafik 46.2%, Administrim Biznesi 44.8%, Ndërtimtaria 45.8%, Instalues Elektrik 36.4%, TIK 37.5%, Hidraulikë dhe Pneumatikë 30%, Instalues i Ujësjellësit dhe kanalizimit 23.8% rezultatet e anketimit tregojnë që kanë punësueshmëri më të ultë. Pasi që në këto profesione mostra ka qenë më e madhe, ndërsa kandidatët e anketuar në pyetjet lidhur me programin e trajnimit, kompetencat e trajnerit, pakon mësimore dhe kushtet e përgjithshme janë shprehur shumë të kënaqur atëherë duhet të bëhet një analizë më e thellë për të gjetur arsytet për këto rezultate.




Figura 1 Të dhënat për punësimin e kandidatëve e trajnuar në QAP për vitet 2014-2016 sipas profesioneve





Figura 2 Të dhënat për punësimin e kandidatëve e trajnuar në QAP për vitet 2014-2016

Tabela 1Të dhënat për Profesione të ofruara nga QAP në periudhën 2014-2016

Nr	Profesioni	Respondentët	M	F	Punon	Nuk Punon	Respondentët që punojnë %	Femrat që punojnë %
1	Administrim biznesi	29	19	10	13	16	44,8	40,7
2	Agrokulturë	15	5	10	10	5	66,7	70
3	As. Admin.	29	14	15	17	12	58,6	87,5
4	Auto elektrik	14	14	0	10	4	71,4	0
5	Dizajn Grafik	13	11	2	6	7	46,2	16,7
6	Floktari	12	0	12	9	3	75,0	100
7	H&P	10	10	0	3	7	30,0	0
8	Hoteleri	12	10	2	11	1	91,7	100
9	Instalues elektrik	22	22	0	8	14	36,4	0
10	Instalues i NQ	8	8	0	8	0	100,0	0
11	Instalues U.K.	21	21	0	5	16	23,8	0
12	Kamarier	17	17	0	13	4	76,5	0
13	Kontabilitet	26	14	12	15	11	57,7	58,35
14	Kuzhinieri	73	47	26	50	23	68,5	46,0
15	Menaxhim i NVMM	7	5	2	6	1	85,7	0,0
16	Mirëmbajtës Objekti	2	2	0	2	0	100,0	0
17	Ndërmarrësi	16	0	16	10	6	62,5	100
18	Ndërtimtari	48	48	0	22	26	45,8	0
19	Pastiçeri	8	1	7	3	5	37,5	0
20	Rrobaqepësi	18	0	18	18	0	100,0	100
21	Saldues	67	67	0	43	24	64,2	0
22	Serv. I.P.Z.	2	2	0	1	1	50,0	0
23	Serviser	9	9	0	5	4	55,6	0
24	TIK	72	19	53	27	45	37,5	33,34
25	Vetëpunësim	18	9	9	17	1	94,4	0
26	Zdrukhëtari	35	35	0	21	14	60,0	0
Total		603	67.8%	32.2%	353	250	58.54%	22.1%

Tabela 2 Të dhënat përmblledhëse për moshën dhe shkollimin e kandidatëve të trajnuar në QAP 2014-2016

	Moshë			Shkollimi			
	16-25	26-35	mbi 35	Fillore	Gjimnaz	AAP	Universitet
Respondentët	221	198	184	101	57	251	194
%	36.7	32.8	30.5	16.7	9.5	41.6	32.2

QAP PRISHTINA

Duke u bazuar në të dhënat e fituara nga anketa për QAP në Prishtinë dhe të paraqitura në tabelën 3, vërehet se përqindja më e madhe e të punësuarve nga tetë profesionet e ofruara është te profesioni i Furrtarisë 100% nga 2 respondentët, Administrim Biznesi 100% prej 1 respondentëve, Ndërtimtari 50% e 8 respondentëve, Servisim i pajisjeve të zyrës 50% e 2 respondentëve dhe Asistent Administrativ 50% e 4 respondentëve. Ndërsa dy profesionet tjera që kanë nën 50% janë Pasticeria 37.5% e 8 respondentëve dhe Auto Elektrikë 40% e 5 respondentëve. Profesionet e TIK nuk ka të punësuar asnjë prej 9 respondentëve, prandaj, për këtë profesion, nevojiten të shikohen një varg aspektesh që kanë të bëjnë me përshkrimin e kualifikimit, pakos mësimore, metodologjisë së aftësimit etj. Për sa i përket profesionit të Furrëtarisë, në bazë të dhënave nga menaxhmenti një numër shumë i madh i kandidatëve që vijnë për certifikim janë nga Regjioni i Hasit dhe shumica dërmuese punojnë në Hungari, Mal të Zi, Kroaci Bosnje dhe Hercegovinë etj dhe ka qenë e pamundshme që të kontaktohen dhe të plotësojnë pyetësorët.

Raporti gjinor i kandidatëve të certifikuar bazuar nga rezultatet e anketës prej 39 respondentëve për QAP në Prishtinë është 61.54% meshkuj dhe 38.46% femra. Femrat nuk janë pjesë e aftësimeve profesionale për profesionet e cilësura si tradicionale për meshkuj: Ndërtimtari, Autoelektrikë, Furrëtarë dhe Servisim i pajisjeve të zyrës.

Tabela 3 Të dhënat për Profesionet e ofruara nga QAP në Prishtinë periudhën 2014-2016

Nr	Profesioni	Nr. Respodentëve	M	F	Punon	Nuk Punon	Respodentët që punojnë %
1.	Pastiçeri	8	12.5	87.5	3	5	37,5
2.	Ndërtimtari	8	100.0	0.0	4	4	50
3.	TIK	9	33.3	66.7	0	9	0
4.	Furrëtarë	2	100.0	0.0	2	0	100
5.	Auto Elektrik	5	100.0	0.0	2	3	40
6.	Adm. Biznesi	1	100.0	0.0	1	0	100
7.	Serv. I P.Z.	2	100.0	0.0	1	1	50
8.	Asistent Admi.	4	50.0	50.0	2	2	50
Total		39	61.54%	38.46%	15	24	

Në tabelën 4 dhe figurën 4 është pasqyruar moshën e pjesëmarrësve të anketuar në aftësime profesionale ku rreth 30,8% janë të rinj 16-25 vjeçar, 33,3% të moshës 26-35 vjeçare dhe 35,9% mbi 35 vjeçar. Sa i përket shkollimit të pjesëmarrësve në trajnime rreth 12,8% janë me shkollë fillore, 15,4% gjimnaz, 25,6% vijnë nga shkollat e aftësimit profesional dhe 46,2% me Universitet.

Tabela 4 Moshën dhe shkollimin e kandidatëve të trajnuar në QAP në Prishtinë 2014-2016

	Moshën			Shkollimi			
	16-25	26-35	mbi 35	Fillore	Gjimnaz	AAP	Universitet
Respodentët	12	13	14	6	6	10	17
%	30,8	33,3	35,9	12,8	15,4	25,6	46,2




Figura 3 Të dhënat për punësimin kandidatët e trajnuar në QAP Prishtinë




Figura 4 Moshë dhe shkollimi i kandidatëve të anketuar në QAP Prishtinë

Në pyetjen 4 se sa e vlerësoni aftësimin në të cilin keni marrë pjesë, 90% e respondentëve japin vlerësimin maksimal (shkëlqyeshëm) dhe 10% shumë të mirë.




Figura 5 Përgjigjet në pyetjen 4 se sa e vlerësoni aftësimin në të cilin keni marrë pjesë në QAP në Prishtinë

Në pyetjen 5 **A mendoni që programi i aftësisimit në QAP ka qenë i përshtatshëm, për t'ju përgatitur për punë**, 90% e respondentëve japin vlerësimin shkëlqyeshëm dhe 10% shumë të mirë.




Figura 6 Përgjigjet në pyetjen 5 **A mendoni që programi i aftësisimit në QAP ju ka përgatitur për punë**

Në pyetjen 6 **A mendoni që pako e aftësisimit dhe materialet kanë qenë të përshtatshme dhe të mjaftueshme**, 82% e respondentëve japin vlerësimin shkëlqyeshëm, 13% shumë të mirë dhe 5% mirë.




Figura 7 Përgjigjet në pyetjen 6 **A mendoni që pako e aftësisimit dhe materialet kanë qenë të përshtatshme dhe të mjaftueshme në QAP në Prishtinë**

Në pyetjen 7 **A mendoni që trajnerët që ju kanë aftësuar kanë përgatitje të duhur profesionale**, 100% e respondentëve japin vlerësimin shkëlqyeshëm.




Figura 8 Përgjigjet në pyetjen 7 **A mendoni që trajnerët kanë përgatitje të duhur profesionale**

Në pyetjen 8 **A janë arritur pritjet tuaja nga Aftësimi Profesional në QAP**, 87% e respondentëve japin vlerësimin shkëlqyeshëm , 10% shumë të mirë dhe 3% mirë, që do të thotë që pritjet e tyre nga aftësimet profesionale të ofruara në QAP në Prishtinë janë përmbushur.




Figura 9 Përgjigjet në pyetjen 8 A janë arritur pritjet tuaja nga Aftësimi Profesional në QAP

Për sa i përket pyetjes 9, sipas të anketuarve fushat aftësimet profesionale duhet të përmirësohen për sa i përket:

- Ofrimit të Punë praktike në ndërmarrje dhe më shumë materiale harxhuese për trajnim,
- Modernizim i pajisjeve ne të cilat bëhet praktikimi i pjesës teorike dhe përcjellja e trendeve,

Për sa i përket pyetjes 10, lidhur me kushtet ekonomike dhe çka do t’ju stimulonte ta vazhdojnë aftësimin profesional, kërkesat e të anketuarve kryesisht kishin të bëjnë me:

- Mundësitë e punësimit dhe
- Mbulimin e shpenzimeve të transportit.

Për sa i përket pyetjes 11, për ndonjë koment apo sugjerim shtesë, komentet e të anketuarve kryesisht kishin të bëjnë me:

- Pajisjen me aparatura për diagnostifikim kompjuterik sidomos për automjete me shumë elektronikë,
- Më shumë pajisje dhe freskimin e programeve të aftësimit dhe materiale mësimore.

QAP PRIZREN

Duke u bazuar në të dhënat e fituara nga anketa për QAP në Prizren dhe të paraqitura në tabelën 5, vërehet se përqindja më e madhe e të punësuarve nga nëntë profesionet e ofruara është te profesioni i vetëpunësimit 100% nga 14 respondentët, pastaj profesioni i Autoelektrikës me 88.9% nga 9 respondentët, ndërsa profesioni i Kuzhinierit ka përqindje të lartë 81.8% të 11 respondentëve. Por, edhe profesionet siç janë Saldimi, Kamarier dhe Floktari kanë përqindje të lartë të punësimit, respektivisht 77.8%, 76,5% dhe 75%. Nga përgjigjet e respondentëve, vërehet një befasi në Profesionin Hidraulikë dhe Pneumatikë, ku vetëm 30% nga 11 respondentët deklarojnë se janë duke punuar, kur dihet se ky profesion është shumë i kërkuar në tregun e punës dhe natyrisht kërkohen kompetenca më të larta dhe nivel më i lartë i kualifikimit. Për sa i përket profesionit Hidraulikë dhe Pneumatikë, sipas Menaxhmentit të QAP dhe trajnerit, shumica e të trajnuarve janë duke punuar dhe ata kanë kontakte të rregullta me ta, megjithatë në pyetësor ata ose e kanë gabuar fushën për plotësim ose kanë hezitur të përgjigjen drejtë.

Raporti gjinor i kandidatëve të certifikuar bazuar nga rezultatet e anketës prej 103 respondentëve për QAP në Prizren është 70.9% meshkuj dhe 29.1% femra. Femrat nuk janë pjesë e aftësimeve profesionale për profesionet e cilësura si tradicionale për meshkuj: saldim, Hidraulikë dhe Pneumatikë, Serviser, por gjithashtu edhe në profesionin kamerier, sikurse meshkujt në profesionin e Floktarisë. Përqindja e femrave që punojnë në profesionet e TIK dhe Kuzhinieri janë shumë të ulëta 16.7%, përkatësisht 9.09%.

Tabela 5 Të dhënat për Profesione të ofruara nga QAP në Prizren periudhën 2014-2016

Nr	Profesioni	Nr. Respondentëve	M	F	Punon	Nuk Punon	Respondentët që punojnë %	Femrat që punojnë %
1.	Saldim	9	9	0	7	2	77,8	0
2.	Vetëpunësim	14	6	8	14	0	100	0
3.	TIK	12	3	9	6	6	50	16,7
4.	H&P	10	10	0	3	7	30	0
5.	Kuzhinieri	11	10	1	9	2	81,8	11,11
6.	Auto elektrik	9	9	0	8	1	88,9	0
7.	Floktari	12	0	12	9	3	75	100
8.	Kamarier	17	17	0	13	4	76,5	0
9.	Serviser	9	9	0	5	4	55,6	0
Total		103	70.9%	29.1%	74	29		

Në tabelën 6 dhe figurën 11 është pasqyruar moshën e pjesëmarrësve të anketuar në aftësime profesionale ku rreth 46,6% janë të rinj 16-25 vjeçar dhe 35% të moshës 26-35 vjeçare. Sa i përket shkollimit të pjesëmarrësve në trajnime rreth 25,2% janë me shkollë fillore, **45,6% vijnë nga shkollat e aftësisimit profesional dhe 16,5% me Universitet.**

Tabela 6 Moshë dhe shkollimi kandidatëve të trajnuar në QAP në Prizren 2014-2016

	Moshë			Shkollimi			
	16-25	26-35	mbi 35	Filllore	Gjimnaz	AAP	Universitet
Respodentët	48	36	19	26	13	47	17
%	46,6	35,0	18,4	25,2	12,6	45,6	16,5




Figura 10 Të dhënat për punësimin kandidatët e trajnuar në QAP Prizren




Figura 11




Figura 12

Në pyetjen 4 se **sa e vlerësoni aftësimin në të cilin keni marrë pjesë**, 88% e respondentëve japin vlerësimin maksimal (shkëlqyeshëm), 11% shumë të mirë, ndërsa vetëm 1% mirë.




Figura 13 Përgjigjet në pyetjen 4 se sa e vlerësoni aftësimin në të cilin keni marrë pjesë në QAP në Prizren

Në pyetjen 5 **A mendoni që programi i aftësimin në QAP ka qenë i përshtatshëm, për t'ju përgatitur për punë**, 79% e respondentëve japin vlerësimin shkëlqyeshëm, 20% shumë të mirë, ndërsa vetëm 1% mirë.




Figura 1 Përgjigjet në pyetjen 5 A mendoni që programi i aftësimin në QAP ju ka përgatitur për punë

Në pyetjen 6 **A mendoni që pako e aftësimin dhe materialet kanë qenë të përshtatshme dhe të mjaftueshme**, 68% e respondentëve japin vlerësimin shkëlqyeshëm, 15% shumë të mirë, 14% mirë, 1% mjaftueshëm dhe vetëm 2% dobët.




Figura 25 Përgjigjet në pyetjen 6 A mendoni që pako e aftësimin dhe materialet kanë qenë të përshtatshme dhe e mjaftueshme në QAP në Prizren

Në pyetjen 7 **A mendoni që trajnerët që ju kanë aftësuar kanë përgatitje të duhur profesionale**, 88% e respondentëve japin vlerësimin shkëlqyeshëm, 10% shumë të mirë dhe vetëm 2 % mirë.




Figura 3 Përgjigjet në pyetjen 7 A mendoni që trajnerët kanë përgatitje të duhur profesionale

Në pyetjen 8 **A janë arritur pritjet tuaja nga Aftësimi Profesional në QAP**, 82% e respondentëve japin vlerësimin shkëlqyeshëm, 14% shumë të mirë, 2% mirë dhe vetëm 2 % mjaftueshëm, që do të thotë që pritjet e tyre nga aftësimet profesionale të ofruara në QAP në Prizren janë përmbushur.




Figura 17 Përgjigjet në pyetjen 8 A janë arritur pritjet tuaja nga Aftësimi Profesional në QAP

Pyetja 9, sipas të anketuarve fushat aftësimet profesionale duhet të përmirësohen për sa i përket:

- Hapësirës më të mëdha të punëtorive,
- Të siguruarit e mjeteve tjera më bashkëkohore dhe të tjera për kuzhinier,
- Mungesën e materialeve të bollshme furnizuese me material shpenzues,
- Pajisje bashkëkohore për diagnostifikim, balancim i gomave, kompjuter për reglzhë,
- Kohëzgjatjen e trajnimit që sipas tyre është e shkurtër,

Pyetja 10, kushtet ekonomike dhe stimulimin:

- Kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit dhe shujta,
- Burimet financiare janë shkaqe për të ndërprerë aftësimin,
- Disa janë shprehur se janë aftësuar dhe kanë nevojë për punë dhe mjete të saldimit,

Pyetja 11, për ndonjë koment apo sugjerim shtesë:

- Shprehin kënaqësinë se çka ju është ofruar dhe ju sugjerojnë punë kërkuesve të ndjekin trajnimet në QAP,
- Zgjerimin e hapësirave të Qendrës për trajnim dhe pajisje sa më profesionale,
- Mungesën e pajisjeve, daljen në teren për punë praktike dhe të zgjatet kohëzgjatja e trajnimit.

QAP MITROVICA

Duke u bazuar në të dhënat e fituara nga anketa për QAP në Mitrovicë dhe të paraqitura në tabelën 7, vërehet se përqindja e të punësuarve në gjashtë profesionet e ofruara është shumë e lartë te profesioni i Rrobaqepësisë 100% nga 18 respondentët, pastaj profesioni i Saldimit me 86.36% nga 22 respondentët, Kuzhinier 100% nga 21 respondentët, te profesioni i ndërtimtarisë përqindja është e lartë nga 8 respondentë punojnë të gjithë. Nga përgjigjet e respondentëve, se përqindja e të trajnuarve në TIK që punojnë është shumë e ultë me vetëm 33% respondentëve prej 18 sa janë përgjigjur.

Raporti gjinor i kandidatëve të certifikuar bazuar nga rezultatet e anketës prej 87respondentëve për QAP në Mitrovicë është 48.3% meshkuj dhe 51.7% femra. Femrat nuk janë pjesë e aftësimeve profesionale për profesionet e cilësura si tradicionale për meshkuj sikurse ato të Ndërtimtarisë dhe Saldim, sikurse meshkujt në profesionin e Rrobaqepësisë. Përqindja e femrave që punojnë në profesionet e TIK dhe Kuzhinieri janë 50%, përkatësisht 65%.

Tabela 7 Të dhënat për Profesione të ofruara nga QAP në Mitrovicë periudhën 2014-2016

Nr	Profesioni	Nr. Respondentëve	M	F	Punon	Nuk Punon	Respondentëve që punojnë %	Femrat që punojnë %
1.	Rrobaqepësi	18	0	18	18	0	100	100
2.	Saldues	22	22	0	19	3	86,36	0.0
3.	Kuzhinier	21	8	13	21	0	100	65.0
4.	TIK	18	4	14	6	12	33,33	50.0
5.	Ndërtimtari	8	8	0	8	0	100	0.0
Total		87	48.3%	51.7%	72	15		

Në tabelën 8 dhe figurën 19 është pasqyruar moshën e pjesëmarrësve të anketuar në aftësime profesionale ku rreth 18,4% janë të rinj 16-25 vjeçar dhe 33.3% të moshës 26-35 vjeçare dhe 48.3% mbi moshën 35 vjeçare. Sa i përket shkollimit të pjesëmarrësve në trajnime rreth 29.9% janë me shkollë fillore, 8% me gjimnaz, **49,4% vijnë nga shkollat e aftësimit profesional dhe 12,6% me Universitet.**

Tabela 8 Moshën dhe shkollimi kandidatëve të trajnuar në QAP në Mitrovicë 2014-2016

	Moshën			Shkollimi			
	16-25	26-35	mbi 35	Fillore	Gjimnaz	AAP	Universitet
Respondentët	16	29	42	26	7	43	11
%	18,4	33,3	48,3	29,9	8,0	49,4	12,6




Figura 4 Të dhënat për punësimin kandidatët e trajnuar në QAP Mitrovicë




Figura 19




Figura 20

Në pyetjen 4 se sa e vlerësoni aftësimin në të cilin keni marrë pjesë, 95% e respodentëve japin vlerësimin maksimal (shkëlqyeshëm) dhe 5% shumë të mirë.




Figura 21 Përgjigjet në pyetjen 4 se sa e vlerësoni aftësimin në të cilin keni marrë pjesë në QAP në Mitrovicë

Në pyetjen 5 A mendoni që programi i aftësimit në QAP ka qenë i përshtatshëm, për t'ju përgatitur për punë, 87% e respondentëve japin vlerësimin shkëlqyeshëm dhe 13% shumë të mirë.




Figura 52 Përgjigjet në pyetjen 5 A mendoni që programi i aftësimit në QAP ju ka përgatitur për punë




Figura 63 Përgjigjet në pyetjen 6 A mendoni që pako e aftësimit dhe materialet kanë qenë të përshtatshme dhe e mjaftueshme në QAP në Mitrovicë

Në pyetjen 6 **A mendoni që pako e aftësisimit dhe materialet kanë qenë të përshtatshme dhe të mjaftueshme**, 78% e respondentëve japin vlerësimin shkëlqyeshëm, 20% shumë të mirë, 1% mirë, 1% mjaftueshëm dhe vetëm 1 % mjaftueshëm.




Figura 74 Përgjigjet në pyetjen 7 **A mendoni që trajnerët kanë përgatitje të duhur profesionale**

Në pyetjen 7 **A mendoni që trajnerët që ju kanë aftësuar kanë përgatitje të duhur profesionale**, 100% e respondentëve japin vlerësimin shkëlqyeshëm.

Në pyetjen 8 **A janë arritur pritjet tuaja nga Aftësimi Profesional në QAP**, 89% e respondentëve japin vlerësimin shkëlqyeshëm dhe 11% shumë të mirë, që do të thotë që pritjet e tyre nga aftësimet profesionale të ofruara në QAP në Mitrovicë janë përmbushur.




Figura 85 Përgjigjet në pyetjen 8 **A janë arritur pritjet tuaja nga Aftësimi Profesional në QAP**

Për sa i përket pyetjes 9, sipas të anketuarve fushat aftësimet profesionale duhet të përmirësohen për sa i përket:

- Ndërrimit të makinave me ato të avancuara ose riparimi i tyre, të ketë sa më shumë materiale,
- Në përgjithësi janë të kënaqur por orari i shkurtër ditor i trajnimit,
- Përmirësimi dhe përditësimi i programeve të aftësisimit, të mbulohen më shumë fusha me module sidomos në fushën e IT,

Për sa i përket pyetjes 10, lidhur me kushtet ekonomike dhe çka do t'ju stimulonte ta vazhdojnë aftësimin profesional, kërkesat e të anketuarve kryesisht kishin të bëjnë me:

- Punësimin,
- Ndjehen të motivuar nga përvoja, certifikimi dhe puna praktike,

- Kërkojnë t'ju sigurohet transporti, ushqimi dhe materialeve e trajnimit.
- Ftesë të gjithë të rinjëve që të aplikojnë për pjesëmarrje në kurset e kuzhinierisë sepse mundësitë janë të mëdha, duke u nisur nga fakti që janë të punësuar dhe ky profesion ka potencial për punësim.

Për sa i përket pyetjes 11, për ndonjë koment apo sugjerim shtesë, komentet e të anketuarve kryesisht kishin të bëjnë me:

- Kënqësinë që e shpehin me atë që ju është ofruar në QAP, e sidomos për ata që punojnë.
- Kohëzgjatjen e kursit të jetë më e gjatë,
- Ankesa për ambientin e brendshëm se është i ftohtë dhe e kanë problem për të mësuar,
- Në fushën e IT duhet të pasurohet me shumë module, të futen gjuhët programuese të cilat krijojnë më shumë mundësi për punësim, siç janë web design, C++, Word Press, Adobe Photoshop.

QAP GJILANI

Duke u bazuar në të dhënat e fituara nga anketa për QAP në Gjilan dhe të paraqitura në tabelën 9, vërehet se përqindja më e madhe e të punësuarve nga gjashtë profesionet e ofruara është te profesioni i Zdrukhtarisë 100% nga 9 respondentët, ndërsa profesionet tjera kanë përqindjen nën 50% si në vijim: Kontabiliteti 42.9% e 14 respondentëve, Administrim Biznesi 20% e 5 respondentëve që njëkohësisht ka përqindjen më të ultë, TIK 30% e 20 respondentëve, saldimi 45% e 20 respondentëve dhe Dizajni Grafik me 46.2% e 13 respondentëve.

Raporti gjinor i kandidatëve të certifikuar bazuar nga rezultatet e anketës prej 81 respondentëve për QAP në Gjilan është 63% meshkuj dhe 37% femra. Femrat nuk janë pjesë e aftësimeve profesionale për profesionet e cilësura si tradicionale për meshkuj: saldim, dhe Zdrukhtari. Përqindja e femrave që punojnë në profesionin Kontabilitet është 66.7%, Administrim Biznesi 100%, ndërsa TIK vetëm 33.3%.

Tabela 9 Të dhënat për Profesione të ofruara nga QAP në Gjilan periudhën 2014-2016

Nr	Profesioni	Nr. Respodentëve	M	F	Punon	Nuk Punon	Respodentët që punojnë %	Femrat që punojnë %
1.	Kontabilitet	14	5	9	6	8	42,9	66,7
2.	Zdrukhtëtari	9	9	0	9	0	100	0,0
3.	Adm. Biznesi	5	1	4	1	4	20	100.0
4.	TIK	20	5	15	6	14	30	33,3
5.	Saldues	20	20	0	9	11	45	0,0
6.	Dizajn Grafik	13	11	2	6	7	46,2	16,7
Total		81	63%	37%	37	44		

Në tabelën 10 dhe figurën 27 është pasqyruar moshën e pjesëmarrësve të anketuar në aftësime profesionale ku rreth 44,4% janë të rinj 16-25 vjeçar dhe 30.9% të moshës 26-35 vjeçare dhe 24.69% mbi moshën 35 vjeçare. Sa i përket shkollimit të pjesëmarrësve në trajnime rreth 9.9% janë me shkollë fillore, 7.4% me gjimnaz, **37,0% vijnë nga shkollat e aftësimin profesional dhe 45,7%** me Universitet, që është QAP e cila ka përqindjen më të lartë të pjesëmarrësve në aftësimin profesional me **Arsim të lartë 45.7%**.

Tabela 10 Moshën dhe shkollimin e kandidatëve të trajnuar në QAP në Gjilan 2014-2016

	Moshën			Shkollimi			
	16-25	26-35	mbi 35	Fillore	Gjimnaz	AAP	Universitet
Respodentët	36	25	20	8	6	30	37
%	44,4	30,9	24,69	9,9	7,4	37,0	45,7




Figura 96 Të dhënat për punësimin kandidatët e trajnuar në QAP Gjilan




Figura 107




Figura 118

Në pyetjen 4 se sa e vlerësoni aftësimin në të cilin keni marrë pjesë, 80% e respondentëve japin vlerësimin shkëlqyeshëm, 16% shumë të mirë dhe 4% të mirë.




Figura 129 Përgjigjet në pyetjen 4 se sa e vlerësoni aftësimin në të cilin keni marrë pjesë në QAP në Gjiilan

Në pyetjen 5 **A mendoni që programi i aftësimit në QAP ka qenë i përshtatshëm, për t’ju përgatitur për punë**, 79% e respondentëve japin vlerësimin shkëlqyeshëm dhe 21% shumë të mirë.




Figura 13 Përgjigjet në pyetjen 5 A mendoni që programi i aftësimit në QAP ju ka përgatitur për punë

Në pyetjen 6 **A mendoni që pako e aftësimit dhe materialet kanë qenë të përshtatshme dhe të mjaftueshme**, 80% e respondentëve japin vlerësimin shkëlqyeshëm dhe 20% shumë të mirë




Figura 141 Përgjigjet në pyetjen 6 A mendoni që pako e aftësimit dhe materialet kanë qenë të përshtatshme dhe të mjaftueshme në QAP në Gjiilan

Në pyetjen 7 **A mendoni që trajnerët që ju kanë aftësuar kanë përgatitje të duhur profesionale**, 94% e respondentëve japin vlerësim të shkëlqyeshëm dhe 6% shumë mirë.




Figura 152 Përgjigjet në pyetjen 7 **A mendoni që trajnerët kanë përgatitje të duhur profesionale**

Në pyetjen 8 **A janë arritur pritjet tuaja nga Aftësimi Profesional në QAP**, 78% e respondentëve japin vlerësimin shkëlqyeshëm, 20% shumë të mirë, 1% mirë dhe 1% mjaftueshëm që do të thotë që pritjet e tyre nga aftësimet profesionale të ofruara në QAP në Gjilan janë përmbushur.




Figura 163 Përgjigjet në pyetjen 8 **A janë arritur pritjet tuaja nga Aftësimi Profesional në QAP**

Për sa i përket pyetjes 9, sipas të anketuarve fushat aftësimet profesionale duhet të përmirësohen për sa i përket:

- Të siguruarit e edhe të punës praktike në biznese,
- Ankohen në teknologjinë e vjetër në objekt të ri,
- Kushteve të mira në objekt por numrit të vogël të kandidatëve.

Për sa i përket pyetjes 10, lidhur me kushtet ekonomike dhe çka do t'ju stimulonte ta vazhdojnë aftësimin profesional, kërkesat e të anketuarve kryesisht kishin të bëjnë me:

- Mundësitë e vogla për punësim,
- Janë të motivuar nga përvoja që marrin, mundësia për certifikim dhe puna praktike,
- Mundësinë e sigurimit të transportit,

Për sa i përket pyetjes 11, për ndonjë koment apo sugjerim shtesë, komentet e të anketuarve kryesisht kishin të bëjnë me:

- Përditësimin e materialeve mësimore,
- Mundësitë e mira që ofron QAP, teknologjinë, praktikën, aftësimin imin
- Mundësinë që trajnimi për kontabilitetin ti shtohet puna praktikë diku në një kompani.

QAP PEJA

Duke u bazuar në të dhënat e fituara nga anketa për QAP në Pejë dhe të paraqitura në tabelën 11, vërehet se përqindja më e madhe e të punësuarve nga njëmbëdhjetë profesionet e ofruara është te profesioni i Kontabilitetit 100% nga 2 respondentët, Asistent Administrativ 72.7% prej 11 respondentëve, Agrokulturë 66.7% e 15 respondentëve, 61.5% Ndërmarrësi prej 13 respodentëve dhe Administrim Biznesi 50% prej 18 respodentëve, ndërsa profesionet tjera kanë përqindjen nën 50% si në vijim: Instalues i Ujësjetës dhe kanalizimit me 5.9% e 17 respondentëve, Ndërtimtari 31.3% e 32 respondentëve, Zdrukhtari 31.6% e 19 respondentëve, Kuzhinieri 11.8% e 11 respondentëve që njëkohësisht ka përqindjen më të ultë. Ndërsa rezultate shumë të dobëta japin profesionet si: Elektronistalues me 0%, të 8 respodentëve.

Raporti gjinor i kandidatëve të certifikuar bazuar nga rezultatet e anketës prej 81 respodentëve për QAP në Pejë është 69.7% meshkuj dhe 30.3% femra. Femrat nuk janë pjesë e aftësimeve profesionale për profesionet e cilësura si tradicionale për meshkuj: Hidroinstalues, Elektronistalues, Instalues i ujësjetës dhe kanalizimit, Ndërtimtari dhe zdrukhtari. Përqindja e femrave që punojnë në profesionin Ndërmarrësi është 100%, Asistent Administrativ 87.5%, Agrokulturë 70%, Kuzhinier 50%, ndërsa Administrim Biznesi vetëm 22.2%.

Tabela 11 Të dhënat për Profesionet të ofruara nga QAP në Pejë periudhën 2014-2016

Nr	Profesioni	Nr. Respodentëve	M	F	Punon	Nuk Punon	Respodentët që punojnë %	Femrat që punojnë %
1.	As. Admin.	11	5	6	8	3	72,7	87,5
2.	Administrim B.	18	14	4	9	9	50,0	22,2
3.	Ndërmarrësi	13	0	13	8	5	61,5	100,0
4.	Kontabilitet	2	1	1	2	0	100,0	50,0
5.	Instalim U.& K.	17	17	0	1	16	5,9	0,0
6.	Elektroinstalues	8	8	0	0	8	0,0	0,0
7.	Ndërtimtari	32	32	0	10	22	31,3	0,0
8.	Zdrukhtari	19	19	0	6	13	31,6	0,0
9.	Agrokulturë	15	5	10	10	5	66,7	70,0
10.	Kuzhinieri	17	10	7	2	15	11,8	50,0
Total		152	69.7%	30.3%	56	96		

Në tabelën 12 dhe figurën 35 është pasqyruar moshën e pjesëmarrësve të anketuar në aftësime profesionale ku rreth 40,1% janë të rinj 16-25 vjeçar dhe 30.9% të moshës 26-35 vjeçare dhe 28.9% mbi moshën 35 vjeçare. Sa i përket shkollimit të pjesëmarrësve në trajnime rreth 13.8% janë me shkollë fillore, 4.6% me gjimnaz, **44.1% vijnë nga shkollat e aftësimit profesional dhe 36,2%** me Universitet, që është QAP e cila ka gjithashtu përqindje shumë të lartë të pjesëmarrësve në aftësim profesional me **Arsim të lartë**.

Tabela 12 Moshë dhe shkollimi kandidatëve të trajnuar në QAP në Pejë 2014-2016

	Moshë			Shkollimi			
	16-25	26-35	mbi 35	Fillore	Gjimnaz	AAP	Universitet
Respodentët	61	47	44	21	9	67	55
%	40,1	30,9	28,9	13.8	5.9	44.1	36.2




Figura 174 Të dhënat për punësimin kandidatët e trajnuar në QAP Pejë




Figura 185




Figura 196

Në pyetjen 4 se **sa e vlerësoni aftësimin në të cilin keni marrë pjesë**, 86% e respondentëve japin vlerësimin shkëlqyeshëm dhe 14% shumë të mirë.




Figura 207 Përgjigjet në pyetjen 4 se sa e vlerësoni aftësimin në të cilin keni marrë pjesë në QAP në Pejë

Në pyetjen 5 **A mendoni që programi i aftësimin në QAP ka qenë i përshtatshëm, për t'ju përgatitur për punë**, 77% e respondentëve japin vlerësimin shkëlqyeshëm, 22 % shumë mirë dhe vetëm 1% mirë.




Figura 218 Përgjigjet në pyetjen 5 A mendoni që programi i aftësimin në QAP ju ka përgatitur për punë

Në pyetjen 6 **A mendoni që pako e aftësisit dhe materialet kanë qenë të përshtatshme dhe të mjaftueshme**, 81% e respondentëve japin vlerësimin shkëlqyeshëm dhe 15% shumë të mirë




Figura 229 Përgjigjet në pyetjen 6 A mendoni që pako e aftësisit dhe materialet kanë qenë të përshtatshme dhe e mjaftueshme në QAP në Pejë

Në pyetjen 7 **A mendoni që trajnerët që ju kanë aftësuar kanë përgatitje të duhur profesionale**, 93% e respondentëve japin vlerësim të shkëlqyeshëm dhe 7% shumë mirë.




Figura 230 Përgjigjet në pyetjen 7 A mendoni që trajnerët kanë përgatitje të duhur profesionale

Në pyetjen 8 **A janë arritur pritjet tuaja nga Aftësimi Profesional në QAP**, 78% e respondentëve japin vlerësimin shkëlqyeshëm, 20% shumë të mirë dhe 2% mirë, që do të thotë që pritjet e tyre nga aftësimet profesionale të ofruara në QAP në Pejë janë përmbushur, por me një dallim të vogël me QAP tjera.




Figura 241 Përgjigjet në pyetjen 8 A janë arritur pritjet tuaja nga Aftësimi Profesional në QAP

Për sa i përket pyetjes 9, sipas të anketuarve fushat aftësimet profesionale duhet të përmirësohen për sa i përket:

- Mungesës së kompjuterëve si dhe vizita në ndërmarrje, biznese, në mënyrë që të shihet nga afër zhvillimi i bizneseve.
- Pajisjeve teknologjike që sipas tyre janë të vjetruara dhe duhet të zëvendësohen me teknologji të re që të kanë mundësitë ti përcjellin zhvillimet aktuale,
- Përmirësimin dhe freskimit të pakove mësimore p.sh. në marketing dhe kontabilitet,
- Mundësisë të ketë më shumë materiale shpenzuese,
- Mundësisë të ketë pajisje laboratorike dhe reagjentë

Për sa i përket pyetjes 10, lidhur me kushtet ekonomike dhe çka do t'ju stimulonte ta vazhdojnë aftësimin profesional, kërkesat e të anketuarve kryesisht kishin të bëjnë me:

- Punësimin,
- Kompensimit të trajnimit me meditare!
- Kompensimit shpenzimeve të udhëtimit dhe shujta,
- Ofrimit të më shumë trajnime që janë të nevojshme dhe kompatible me tregun,
- Mundësive të mira që ju ka ofruar QAP dhe që me të përfunduar janë punësuar ose kanë hapur biznes të ri.

Për sa i përket pyetjes 11, për ndonjë koment apo sugjerim shtesë, komentet e të anketuarve kryesisht kishin të bëjnë me:

- Shprehjen kënaqësisë nga mënyra e komunikimit të trajnerës me kandidatë, aftësia e saj profesionale si dhe aftësimi është shumë lehtësuese për kandidatët,
- Kërkesës që QAP duhet të promovojë më shumë programet e aftësimin,
- Shprehjen e kënaqësisë që kanë qenë pjesë e trajnimeve dhe e vlerësojnë shumë mënyrat e mësimdhënies,
- Kërkesën për makineri me të avancuara dhe CNC.

QAP FERIZAJ

Duke u bazuar në të dhënat e fituara nga anketa për QAP në Ferizaj dhe të paraqitura në tabelën 13, vërehet se përqindja më e madhe e të punësuarve nga njëmbëdhjetë profesionet e ofruara është te profesioni i Mirëmbajtës objekti 100% nga 2 respondentët, Instalues i ngrohjes qendrore 100% prej 8 respondentëve, Instalues i Ujësjellësit dhe kanalizimit 100% e 4 respondentëve, Hoteleri 91.7% e 12 respondentëve, Kuzhinieri 72.7% e 22 respondentëve, Zdrukhtari 85.7% e 7 respondentëve, TIK 69.2% e 13 respondentëve dhe Saldues 55.6% e respondentëve. Ndërsa dy profesionet tjera siç janë Kontabiliteti dhe Administrim Biznesi 0% e 2 përkatësisht 1 respondentëve.

Raporti gjinor i kandidatëve të certifikuar bazuar nga rezultatet e anketës prej 81 respondentëve për QAP në Ferizaj është 69.7% meshkuj dhe 30.3% femra. Femrat nuk janë pjesë e aftësimeve profesionale për profesionet e cilësura si tradicionale për meshkuj: Hidroinstalues, Elektroninstalues, Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit, Ndërtimtari dhe zdrukhtari. Përqindja e femrave që punojnë në profesionin Ndërmarrësi është 100%, Asistent Administrativ 87.5%, Agrokulturë 70%, Kuzhinier 50%, ndërsa Administrim Biznesi vetëm 22.2%.

Tabela 13 Të dhënat për Profesionet e ofruara nga QAP në Ferizaj periudhën 2014-2016

Nr	Profesioni	Nr. Respondentëve	M	F	Punon	Nuk Punon	Respondentët që punojnë %	Femrat që punojnë %
	Instalues elektrik	9	9	0	6	3	66.7	0.0
	Administrim biznesi	2	1	1	0	2	0.0	0.0
	Kontabilitet	1	1	0	0	1	0.0	0.0
	Hoteleri	12	10	2	11	1	91.7	100.0
	Kuzhinieri	22	17	5	16	6	72.7	60.0
	Mirëmbajtës Objekti	2	2	0	2	0	100.0	0.0
	Zdrukhtari	7	7	0	6	1	85.7	0.0
	Saldues	9	9	0	5	4	55.6	0.0
	TIK	13	4	9	9	4	69.2	66.7
	Instalues i ngrohjes qendrore	8	8	0	8	0	100.0	0.0
	Instalues ujësjellësi, Kanalizimi	4	4	0	4	0	100.0	0.0
	Total	89	80.9%	19.1%	67	22		

Në tabelën 14 dhe figurën 43 është pasqyruar moshën e pjesëmarrësve të anketuar në aftësime profesionale ku rreth 31.5% janë të rinj 16-25 vjeçar dhe 31.5% të moshës 26-35 vjeçare dhe 37.1% mbi moshën 35 vjeçare. Sa i përket shkollimit të pjesëmarrësve në trajnime rreth 11.2% janë me shkollë fillore, 14.6% me gjimnaz, **43.8% vijnë nga shkollat e aftësimit profesional dhe 30,3% me**

Universitet, që është QAP e cila ka gjithashtu përqindje shumë të lartë të pjesëmarrësve në aftësim profesional me arsim dhe **aftësim profesional dhe Arsim të lartë**.

Tabela 14 Moshë dhe shkollimi kandidatëve të trajnuar në QAP në Ferizaj 2014-2016

	Moshë			Shkollimi			
	16-25	26-35	mbi 35	Fillore	Gjimnaz	AAP	Universitet
Responentët	28	28	33	10	13	39	27
%	31.5	31.5	37.1	11.2	14.6	43.8	30.3




Figura 252 Të dhënat për punësimin kandidatët e trajnuar në QAP Ferizaj




Figura 263

Në pyetjen 4 se **sa e vlerësoni aftësimin në të cilin keni marrë pjesë**, 92% e responentëve japin vlerësimin shkëlqyeshëm dhe 8% shumë të mirë.




Figura 274




Figura 285 Përgjigjet në pyetjen 4 se sa e vlerësoni aftësimin në të cilin keni marrë pjesë në QAP në Ferizaj

Në pyetjen 5 A mendoni që programi i aftësimin në QAP ka qenë i përshtatshëm, për t'ju përgatitur për punë, 89% e respondentëve japin vlerësimin shkëlqyeshëm, 10% shumë mirë dhe vetëm 1% mirë.




Figura 296 Përgjigjet në pyetjen 5 A mendoni që programi i aftësimin në QAP ju ka përgatitur për punë

Në pyetjen 6 **A mendoni që pako e aftësisimit dhe materialet kanë qenë të përshtatshme dhe të mjaftueshme**, 68% e respondentëve japin vlerësimin shkëlqyeshëm, shumë mirë 30% dhe 2% shumë të mirë.




Figura 307 Përgjigjet në pyetjen 6 A mendoni që pako e aftësisimit dhe materialet kanë qenë të përshtatshme dhe e mjaftueshme në QAP në Ferizaj

Në pyetjen 7 **A mendoni që trajnerët që ju kanë aftësuar kanë përgatitje të duhur profesionale**, 92% e respondentëve japin vlerësim të shkëlqyeshëm dhe 8% shumë mirë.




Figura 318 Përgjigjet në pyetjen 7 A mendoni që trajnerët kanë përgatitje të duhur profesionale

Në pyetjen 8 **A janë arritur pritjet tuaja nga Aftësimi Profesional në QAP**, 87% e respondentëve japin vlerësimin shkëlqyeshëm dhe 13% shumë të mirë, që do të thotë që pritjet e tyre nga aftësimet profesionale të ofruara në QAP në Ferizaj janë përmbushur, por me një dallim të vogël me QAP tjera.




Figura 329 Përgjigjet në pyetjen 8 A janë arritur pritjet tuaja nga Aftësimi Profesional në QAP

Për sa i përket pyetjes 9, sipas të anketuarve fushat aftësimet profesionale duhet të përmirësohen për sa i përket:

- Të siguruarit e edhe të punës praktike në biznese,
- Furnizimi me më shumë material pune, në mënyrë që kandidatët të kenë mundësi të punojnë të gjithë dhe me kohë,
- Të siguruarit e pajisjeve më të sotifikuara,
- Kërkesës që të përditësohen programet e aftësimit dhe paketot mësimore,

Për sa i përket pyetjes 10, lidhur me kushtet ekonomike dhe çka do t'ju stimulonte ta vazhdojnë aftësimin profesional, kërkesat e të anketuarve kryesisht kishin të bëjnë me:

- Shujten ditore, mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit,

Për sa i përket pyetjes 11, për ndonjë koment apo sugjerim shtesë, komentet e të anketuarve kryesisht kishin të bëjnë me:

- Thirrjen drejtuar atyre që dëshirojnë për të punuar në gastronomi, tani e kanë adresën ku mund të aftësohen, në shkollën profesionale të gastronomisë në Ferizaj.

QAP GJAKOVA

Duke u bazuar në të dhënat e fituara nga anketa për QAP në Gjakovë dhe të paraqitura në tabelën 15, vërehet se përqindja më e madhe e të punësuarve nga tetë profesionet e ofruara është te profesioni i Menaxhim i NVM 85.7% nga 7 respondentët, Kontabilitet 77.8% e 9 respondentëve, Vetëpunësim 75% prej 4 respondentëve, Ndërmarrësi 66.7% e 3 respondentëve, Administrim Biznesi 66.7% e tre respondentëve dhe Asistent Administrative 50% e 14 respondentëve. Ndërsa dy profesionet tjera punësimin e kanë nën 50%, Saldues 42.9% e 7 respondentëve dhe Instalues Elektrik 40% e 5 respondentëve.

Raporti gjinor i kandidatëve të certifikuar bazuar nga rezultatet e anketës prej 81 respondentëve për QAP në Gjakovë është 69.2% meshkuj dhe 30.8% femra. Femrat nuk janë pjesë e aftësimeve profesionale për profesionet e cilësura si tradicionale për meshkuj: Instalues Elektrik dhe Saldues. Përqindja e femrave që punojnë në profesionin Asistent Administrativ është 85.7%, Ndërmarrësi 100%, Vetëpunësim 33.3%, Kontabilitet 14.3%, ndërsa nuk punojnë fare në profesionet siç janë; Menaxhim i NVM dhe Administrim Biznesi.

Tabela 15 Të dhënat për Profesionet të ofruara nga QAP në Gjakovë periudhën 2014-2016

Nr	Profesioni	Nr. Respondentëve	M	F	Punon	Nuk Punon	Respondentët që punojnë %	Femrat që punojnë %
1.	Asistent Ad.	14	7	7	7	7	50.0	85.7
2.	Saldues	7	7	0	3	4	42.9	0.0
3.	Instalim ELE.	5	5	0	2	3	40.0	0.0
4.	Menaxhim NVM	7	5	2	6	1	85.7	0.0
5.	Vetëpunësim	4	3	1	3	1	75.0	33.3
6.	Kontabilitet	9	7	2	7	2	77.8	14.3
7.	Ndërmarrësi	3	0	3	2	1	66.7	100.0
8.	Administrim Bi.	3	2	1	2	1	66.7	0.0
Total		52	69.2%	30.8%	32	20		

Në tabelën 16 dhe figurën 51 është pasqyruar moshën e pjesëmarrësve të anketuar në aftësi profesionale ku rreth 38.5% janë të rinj 16-25 vjeçar dhe 38.5% të moshës 26-35 vjeçare dhe 23.1% mbi moshën 35 vjeçare. Sa i përket shkollimit të pjesëmarrësve në trajnime rreth 7.7% janë me shkollë fillore, 5.8% me gjimnaz, **28.8% vijnë nga shkollat e aftësisë profesionale dhe 57.7%** me Universitet, që është QAP e cila ka gjithashtu përqindje shumë të lartë të pjesëmarrësve në aftësim profesional me arsim dhe **aftësim profesional dhe Arsim të lartë.**

Tabela 16 Moshën dhe shkollimi i kandidatëve të trajnuar në QAP në Gjakovë 2014-2016

Respondentët	Moshën			Shkollimi			
	16-25	26-35	mbi 35	Fillore	Gjimnaz	AAP	Universitet
	20	20	12	4	3	15	30
%	38.5	38.5	23.1	7.7	5.8	28.8	57.7




Figura 330 Të dhënat për punësimin kandidatët e trajnuar në QAP Gjakovë




Figura 341




Figura 352

Në pyetjen 4 se **sa e vlerësoni aftësimin në të cilin keni marrë pjesë**, 73% e respondentëve japin vlerësimin shkëlqyeshëm, 25% shumë mirë dhe 2% mirë.




Figura 363 Përgjigjet në pyetjen 4 se sa e vlerësoni aftësimin në të cilin keni marrë pjesë në QAP në Gjakovë

Në pyetjen 5 A mendoni që programi i aftësimin në QAP ka qenë i përshtatshëm, për t'ju përgatitur për punë, 69% e respondentëve japin vlerësimin shkëlqyeshëm, 29% shumë mirë dhe vetëm 2% mirë.




Figura 374 Përgjigjet në pyetjen 5 A mendoni që programi i aftësimin në QAP ju ka përgatitur për punë

Në pyetjen 6 A mendoni që pako e aftësimin dhe materialet kanë qenë të përshtatshme dhe të mjaftueshme, 75% e respondentëve japin vlerësimin shkëlqyeshëm, shumë mirë 23% dhe 2% të mirë.




Figura 385 Përgjigjet në pyetjen 6 A mendoni që pako e aftësimin dhe materialet kanë qenë të përshtatshme dhe e mjaftueshme në QAP në Gjakovë

Në pyetjen 7 **A mendoni që trajnerët që ju kanë aftësuar kanë përgatitje të duhur profesionale**, 86% e respondentëve japin vlerësim të shkëlqyeshëm, 6 % shumë mirë dhe 8% mirë.




Figura 396 Përgjigjet në pyetjen 7 **A mendoni që trajnerët kanë përgatitje të duhur profesionale**

Në pyetjen 8 **A janë arritur pritjet tuaja nga Aftësimi Profesional në QAP**, 62% e respondentëve japin vlerësimin shkëlqyeshëm dhe 27% shumë të mirë dhe 11% të mirë që do të thotë që pritjet e tyre nga aftësimet profesionale të ofruara në QAP në Gjakovë janë përmbushur, por me një dallim të vogël me me QAP tjera.




Figura 407 Përgjigjet në pyetjen 8 **A janë arritur pritjet tuaja nga Aftësimi Profesional në QAP**

Për sa i përket pyetjes 9, sipas të anketuarve fushat aftësimet profesionale duhet të përmirësohen për sa i përket:

- Hapësirave të punëtorisë për saldime duhet të jetë pak më e madhe,
- Kërkesës që të ofrohet mundësia për praktikë në biznese,
- Kërkesës për më shumë materiale shpenzuese për trajnim.

Për sa i përket pyetjes 10, lidhur me kushtet ekonomike dhe çka do t'ju stimulonte ta vazhdojnë aftësimin profesional, kërkesat e të anketuarve kryesisht kishin të bëjnë me:

- Shujtën ditore, mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit,
- Avancimin e vazhdueshëm, praktika dhe mësimi i gjërave të reja krahas me zhvillimin e teknologjisë,
- Sigurimi i praktikës me pagesë në biznese që do të pasonte për kandidatët që arrijnë të e përfundojnë programin me sukses.

Për sa i përket pyetjes 11, për ndonjë koment apo sugjerim shtesë, komentet e të anketuarve kryesisht kishin të bëjnë me:

- Kërkesës që programeve bazike të trajnimit t’ju shtohen edhe programe më specifike të cilat do të ndjekëshin nga personat që dëshirojnë të profilizohen,
- Sigurimi i materialeve mësimore në sasi më të mëdha,
- Sugjerojnë që për kandidatët të cilët vijojnë aftësimin të aftësohen edhe me pajisje me të avancuara (me teknika me të reja),
- Sugjerojnë të hapen më shumë profesione.

KONKLuzionet dhe Rekomandimet

Në bazë të rezultateve të fituara të anketimit do të paraqesim në vijim vetëm disa nga konkluzionet dhe rekomandimet e përgjithshme:

- Të gjithë kandidatët e intervistuar janë të certifikuar dhe kanë kryer 1 deri 12 module të aftësisimit profesional në QAP, me kohëzgjatje zakonisht 1 deri 6 muaj, por ka edhe 7- 12 muaj.
- Në përgjithësi kandidatët janë të kënaqur me kushtet e përgjithshme që ofrojnë QAP, përfshirë, programet, trajnerët, paketat dhe materialet mësimore dhe infrastrukturën.
- Disa profesione kanë rezultate të ulëta të punësimit për kandidatët e certifikuar (shih tabelën 2), megjithatë për disa profesione është vështirë të nxirren konkluzione të besueshme dhe të parashihet trendi për shkak të numrit të vogël të pyetësorëve të plotësuar (1 deri 4), prandaj edhe të gjeturat mund të mos pasqyrojnë gjendjen reale.
- Lidhja e profesioneve të ofruara nga QAP me kërkesat e tregut të punës është çështje që duhet të adresohet seriozisht nga QAP, kjo nënkupton zhvillimin dhe freskimin e Standardeve të profesionit, Kualifikimeve profesionale konform këtyre standardeve dhe pakove mësimore.
- Nga anketimi si çështje motivuese shihen; rritja e punësueshmërisë në disa profesione, ofrimi i përkrahjes financiare për shujtën dhe transportin, si dhe punës praktike në ndonjë kompani.
- Mungesa e materialeve të mjaftueshme për punë praktike është shfaqur si mangësi nga shumica e të anketuarve.
- Avancimi dhe shtimi i pajisjeve, makinerive dhe teknologjisë është kërkesa e shumicës së kandidatëve të trajnuar të cilët ose janë punëkërkuar ose ka nga ta edhe që punojnë por kanë nevojë për certifikim dhe freskim të njohurive në profesione të caktuara.
- Kandidatët e anketuar kanë sugjeruar për më shumë promovim nga Agjencioni dhe QAP, për ofertën për programe dhe mundësi që ofrojnë QAP.
- Agjencioni i punësimit duhet të adresoj edhe çështjen gjinore, sepse të gjeturat e hulumtimit tregojnë një përfaqësim relativisht të ultë të gjinisë femërore në trajnimet e ofruara nga QAP me vetëm 32.2%, ndërsa edhe në totalin prej 58.54% të kandidatëve të punësuar, vetëm 22.1% prej tyre janë femra.
- Për sa i përket moshës së kandidatëve nga rezultatet e anketimit shohim një përfaqësim përafërsisht të barabartë të tri kategorive: 16-25 vjet me 36.7%, 26-35 vjet me 32.8% dhe mbi 35 vjet 30.5%.
- Gjithashtu Qeveria e Kosovës dhe MASHT, duhet që urgjentisht dhe seriozisht ta trajtojë çështjen e cilësisë së sistemit të arsimit në Shkollat Profesionale (SHP) dhe Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL), pasi që rezultatet e hulumtimit tregojnë se 46.1% e kandidatëve të anketuar vijnë nga SHP, ndërsa 32.2% nga IAL, e kjo ndikon në rritjen e kostos për përgatitjen e këtyre njerëzve për tregun e punës.
- Bazuar në rezultatet e anketimit duhet përsëri të ri-theksohet rritja e bashkëpunimit ndërmjet AP dhe MASHT, për bashkëpunim të mirëfilltë dhe në shfrytëzimin e përbashkët të resurseve në dispozicion për ta përmirësuar punësueshmërinë.

SHTOJCA 1: KOMENTET E TË ANKETUARVE (RESPONDENTËVE)

QAP PRISHTINA

Pyetja 9: Cilat fusha nga aftësimet profesionale duhet të përmirësohen	Pyetja 10: Nëse jetoni në kushte të vështira ekonomike, çka do t'ju stimulonte ta vazhdoni aftësimin?	Pyetja 11: Komente apo sugjerime tjera.
0	Paratë	0
0	0	Qendër shumë e mirë për trajnimin e personave për një zanat
Në pastiqeri nuk ka nevojë për shumë por shumë mirë ka qenë	Për punësim	Ka qenë trajnim tepër i mirë dhe kemi kaluar shumë mirë gjatë trajnimit
0	Për punësim në Pastiqeri	0
0	0	Jam aftësuar për Ëmbëltorë
Puna praktike më shumë si dhe materialet harxhuese	0	0
Më shumë praktikë tek Kompanitë vendore	0	0
Unë mendoj që çdo gjë është në rregull.	0	0
Hapësirat për demonstrimin e mundshëm për një të arritur idenë profesionale dhe më shumë furnizim me material.	Te më ofrohet ndonjë punë në drejtimin që kam për të pasur më shumë siguri dhe kushte normale për punën dhe që puna profesionale të arrij qëllimin e saj të mirëfilltë.	Të vlerësohet çdo certifikim nga Qeveria dhe tu mundësohet kandidatëve që të punësohen në drejtimet e tyre përkatëse.
Çdo gjë ka qenë në rregull	Motivi për hyrje në treg	0
Çdo gjë ka qenë në rregull	Për një të ardhme me të mirë.	0
0	0	0
0	0	0
0	Sikur të isha në marrëdhënie pune në profesion, ky do të ishte një stimulim i madh	Ka qenë e domosdoshme hapja e kësaj qendre për aftësim profesional
Vetëm të vazhdoj punën kështu	0	0
0	Të sigurohet transporti, të jetë qendra më afër vendbanimit	Të mos ndalet puna shkakut i materialit
Fusha e auto elektrikes duhet të ndjek trendët me të reja të auto elektrikes	Pa dyshim do të kisha vazhduar aftësimin profesional si praktikant me pagesë	Mendoj se duhet të ketë më shumë pajisje të auto elektrikes në qendrën e aftësimit profesional
Mungojnë pajisje të reja (duhet furnizuar)	Lehtësime trajnimi	Duhet diagnostifikim kompjuterik sidomos për automjete me shumë elektronikë
Duhet ndërtuar pjesa praktike	Do ta vazhdoja pasi që është profesion shumë i përshtatshëm për një person	Pajisje diagnostike
Modernizim i pajisjeve në të cilat bëhet praktikimi i pjesës teorike	Specializim	Modernizim i aparaturave dhe kompjuterëve
Mjetet e konkretizimit	Ndihma materiale	Duhet pajisje të reja në hap me kohën
Pajisjet kompjuterike	Shpresa vdes e fundit, Profesori i mirë	Për nga ana e ligjërimit ka qenë perfekt por pajisjet në të cilat

		kemi punuar i kem i pas aftësitë e kufizuara
Për mendimin tim të gjitha fushat kanë qenë të përmirësuara	Ndonjë aftësim profesional qe do sigurate punësimin e menjëhershëm	Nuk kam komente tjera, qëllimi dhe dëshira ime është qe me këtë aftësim profesional të punësohem
Të gjitha kanë qenë në rregull	0	0
Përmirësimi i një bufeje, kompjuterë të rinjë	Pagesa e udhëtimit	0
Mirë ishte për mendimin tim	Do të aftësohesha ne një profesion qe do të sigurate punësim	Sipas mendimit tim ka qenë çdo gjë në rregull.

QAP GJILANI

Pyetja 9: Cilat fusha nga aftësimet profesionale duhet të përmirësohen	Pyetja 10: Nëse jetoni në kushte të vështira ekonomike, çka do t'ju stimulonte ta vazhdoni aftësimin?	Pyetja 11: Komente apo sugjerime tjera
Duhet të ketë disa orë praktike në kompani.	Duhet transport për në QAP - është larg stacionit të autobusëve	Nuk ka
Çdo gjë ka qenë në rregull, nuk shoh diçka që duhet të përmirësohet.	Përvojën të cilën e fitojmë, certifikimi, puna praktike.	0
Të gjitha kanë qenë në rregull	Certifikatat, përvoja të cilën e fitojmë, puna praktike.	0
Nga fusha e ekonomisë ka qenë Kontabiliteti i nevojshëm dhe është realizuar mirë nga trajnerja.	Asgjë, nevoja për punë, ndoshta.	Nuk kam komente
Sipas mendimit tim duhet të krijohen kushte me të mira si p.sh. krijimi i praktikës në Kompani në mënyrë që të përgatitemi me shumë profesionalisht për të ardhmen.	Si stimulim do të ishte transporti i siguar nga QAP si dhe ofrimi i ndonjë vendi të punës pas përfundimit me sukses të trajnimit.	Mbes me shpresë që fjalët e mia do të merren parasysh pasi që besoj që në këtë mënyrë do të rritej më shumë rejtingu i Qendrës.
Nuk mendoj se ka nevojë për përmirësime pasi që të gjitha janë në mënyrë perfekte sa i përket aftësimin profesional.	Arsyeja që vendosa ta vazhdoj aftësimin është fakti se nëse jam aftësuar mjaftueshëm ta kem me të [lehtë] vendimin për punë afat gjatë.	Puna që ju ofroni për aftësim profesional është e mrekullueshme, sa i përket sugjerimit vet kërkoj nga ju që të mos ndikoni duke punuar për aftësimin e të rinjve në fushat e ndryshme profesionale.
Unë mendoj që duhet të ketë më shumë praktikë ndërsa fushat tjera për mendimin tim jam në rregull.	Mendoj që do të nevojitej transporti deri tek Qendra sepse është pak larg.	Përderisa ne do të kryejmë trajnimet në QAP mendoj që të na hyjnë në punë, edhe pse ne do të kryejmë trajnime prapë se prapë nuk kemi punë.
Aftësimet profesionale mendoj: Gjuha Angleze, si dhe në trajnimet tjera të futet si dhe puna praktike.	Stimulimi do të ishte siguri i vendit të punës përmes fushave të trajnimit në PC, gjuhë, Kontabilitet si dhe punë praktike.	Lloje të ndryshme të trajnimeve, më shumë trajner dhe numër më të madh të rinjve.
0	Qendra për Aftësim profesional gjendet larg qendrës së qytetit dhe qytetet kanë nevojë për ndonjë mjet transporti për të udhëtuar.	Literatura të reja të ndërrohen, të mbahet më shumë punë praktike për Kontabilitet.
Nuk kisha dashtë të përmirësohen aftësimet profesionale mirëpo të kem përparësi që të marrim pjesë në ndonjë projekt apo praktikë për punë.	Qendra për Aftësim profesional ndodhet larg qendrës së qytetit dhe duhet mjet transporti për të shkuar deri tek Qendra.	Trajnimit të Kontabilitetit i nevojitet edhe një praktikë në ndonjë kompani në mënyrë që ato njohuri, të arritura në atë trajnim të shprehen apo shfaqen në mënyrë që të kompletohet trajnimi dhe t[ë] bëhet një praktikë.
Një pjesë e modulit j[ë] jetë në mënyrë praktike, që të përballemi me realitetin në praktikë	Për shkak të vendit i cili ndodhet larg, të sigurohet një mjet transportues për të arritur te vendi i duhur.	Këto trajnime të vazhdojnë sepse janë të domosdoshme dhe të arrihen marrëveshje me firma private ose institucione të ndryshme rreth pjesës praktike
Mendoj që kushtet janë të mira për mësim vetëm teknologjinë pak ta	Qendra e kursit ku gjendet objekti është pak larg nga	Duke mësuar dhe duke u trajnuar në QAP, mendoj se do ndihmojë

ndërrojmë. Kushtet në objekte janë të mira, vetëm të rritet numri i nxënësve.	qyteti, rruga për të ardhur deri te kursi është e papërshtatshme. Unë mendoj që do të ishte më mirë të kishte transport urban.	nxënësit. Ne QAP ka teknologji, praktikë, aftësim të suksesshëm dhe mendoj që është mirë të vazhdohet të punohet kështu për të ardhmen e studentëve, nxënësve.
Mendoj se trajnimi në Kontabilitet ka pasur të përfshirë edhe teorinë edhe praktikën, prandaj mendoj se duhet të vazhdoj njëjtë, vetëm të përcjellë ndryshimet tatimore që ndodhin.	Objekti gjendet larg qytetit dhe nuk ka transport urban prandaj sigurimi i transportit do të ishte i mirëseardhur.	Duke pasur parasysh zhvillimin ekonomik teknologjik, mendoj se QAP duhet të ofroj trajnime në marketing digjital, animacione dhe fusha të tjera të teknologjisë informative.
Mas aftësimi të trajnimit të vazhdoj praktikën diku në ndonjë kompani tremujore	Unë do të vazhdoja nëse ka transport, dhe ndonjë vend të punës nëse është e sigurtë.	Trajnimit të kontabilitetit i nevojitet edhe një praktikë diku në një kompani
Unë mendoj që duhet të përmirësohet pjesa praktike e atyre që kemi mësuar d.m.th. në ndonjë kompani etj...	Nëse do të jetoja në kushte të vështira ekonomike, për ta vazhduar aftësimin do të më stimulonte mendimi që një ditë me atë aftësim do të punësohem.	Komenti im për QAP do të ishte se trajnerët janë në nivel të lartë, të vazhdohet me këtë ritëm. Ndërsa sugjeroj që të mbahet edhe praktikë e asaj pjese që kemi mësuar.
Aftësimi ka qenë në rregull, por do të doja disa orë praktikë me i mbajt jashtë QAP-it në ndonjë kompani.	Me siguri transportin, sepse është larg nga qendra e qytetit dhe është e pamundur të vijmë në këmbë.	Trajnimi ka qenë shumë në rregull, profesoresha ka qenë në nivel të lartë, ka arrite me na kuptua rsecilin veç e veç. Nga ky trajnim jam nda shumë e kënaqur.
Ka nevojë për përmirësimin dhe avancimin e programit informatikë IT, të ofrohen trajnime shtesë, dhe në administrim biznesi të zgjatet programi.	Nëse do të jetoja në kushte të vështira mendoj që si stimulim do të ishte ofrimi i transportit falas.	Të zgjaten më shumë programet në mënyrë që të ofrohet më shumë aftësim dhe njohuri, module tjera që do na ndihmonin në fushën e ekonomisë.
0	Unë do ta vazhdoja aftësimin në kontabilitet, trajnerja qenë shumë e aftë për trajnimin paraprak. Kjo është stimulimi im që të vazhdoj aftësimin dhe arsyeja se përfiton shumë nga QAP.	Nuk kam informata mirëpo si sugjerim në kontabilitet nëse nuk mbahet praktika, me ia mundësuar vijuesve, të mbajnë praktikë në kompani të ndryshme, me pas mundësi të kyçjes më të lehtë në punë përmes QAP.
Dëshiroj që të kemi mundësinë të trajnohem në një ndërmarrje për të forcuar administrim biznesi.	Punësimi mundësisht edhe një mjet transporti për shkak se qendra është larg.	Skam fjalë të përshtatshme për kënaqësinë gjatë trajnimit.

QAP MITROVICA

Pyetja 9: Cilat fusha nga aftësimet profesionale duhet të përmirësohen	Pyetja 10: Nëse jetoni në kushte të vështira ekonomike, çka do t'ju stimulonte ta vazhdoni aftësimin?	Pyetja 11: Komente apo sugjerime tjera.
Rregullimi i makinave	0	Trajnerja ka qenë shumë aktive me ne, u është përgjigjur kërkesave tona gjithmonë. Jam shumë e kënaqur me trajneren.
0	0	Kisha propozuar për pajisje me të reja.
Ndërrimi i makinave me ato të avancuara ose riparimi i tyre, të ketë saktësisht shumë materiale për kursantë.	0	Trajnerja ka qenë shumë aktive dhe e kujdesshme për çdo kërkesë tonën.
Makinat duhet të jenë më të avancuara, material shpenzues të ketë të mjaftueshëm.	0	Jam shumë e kënaqur me ndihmën që kanë dhënë këtu në QAP për aftësim në profesion dhe shumë falënderuese për mësuesen.
Kisha me cekur që vetëm pajisjet të jenë me të reja.	0	0
0	0	Në përgjithësi ka qenë shumë mirë vetëm në furnizim me materiale harxhuese ka nevojë më shumë.
Pajisjet janë të vjetra	0	0
Gjithmonë ka hapësirë për përmirësim dhe shtyrje të gjërave përpara. Mendoj që është i nevojshëm zhvillimi i Kurrikulit të profesionit të Rrobaqepësisë.	0	Jam shumë e kënaqur nga vijimi i këtij kursi mirëpo për të ardhmen unë dëshiroj që gjërat të shkojnë përpara, përmirësim i kushteve, pajisje me të reja që ndikojnë në përmirësimin e trajnimit.
0	0	Kam kaluar shumë mirë në QAP dhe jam shumë falënderuese ndaj mësimeve të mësuara.
0	0	Unë jam ndarë shumë e kënaqur me trajnimin në përgjithësi.
0	Vetëm të na ofroni punë	Çdo gjë ka qenë në rregull, vetëm ju faleminderit për aftësimin që na keni dhënë.
0	0	Shumë mirë ka qenë në përgjithësi.
0	0	Mjaft mirë ka qenë, jemi të kënaqur me aftësimin profesional dhe faleminderit nga Shkolla QAP.
0	Vetëm me u kualifikuar me Çertifikatë.	Çdo gjë ka qenë në rregull.
0	Vetëm të na ofroni punë	Çdo gjë ka qenë në rregull, vetëm ju faleminderit për aftësimin që na keni dhënë.
0	Të na ofronte punë	Çdo gjë ka qenë në rregull, vetëm ju faleminderit për mundësinë.
Të ketë lidhshmëri me punët e Agjuntorit	0	0
Nxemja e lokalit e pamjaftueshme	0	Furnizimi më i rregullt me material trajnues
0	0	0

0	0	0
Të plotësohet me ndonjë modul nga Agjustatoria	0	0
0	0	Furnizimi të jetë më i mirë
0	0	Salla është pak e ftohtë dhe furnizimi me material mundet me qenë me i mirë.
Sa i përket punës që bëjë në Fabrikë do të ishte i mirë edhe aftësimi për Agjitor	0	Sa i përket Qendrës për Aftësim (QAP) stafi punues është i përkryer, është mirë të furnizohen me materiale praktike.
Axhustator	0	0
Nëse ka mundësi të ketë më shumë për axhustatorë.	0	0
Për axhustator	0	0
Fusha e opionatit-mog	0	0
Çdo gjë ka qenë mirë por kohëzgjatja e kursit të jetë edhe 1 ose 2 muaj më e gjatë.	Shpresa për punësim	Nuk kam sugjerime tjera, çdo gjë në rregull.
Çdo gjë ka qenë në rregull.	Ju kisha preferuar të gjithë të rinjëve që të aplikojnë për pjesëmarrje në kurset e kuzhinierisë sepse mundësitë janë të mëdha, duke u nisur nga fakti që ne jemi të gjithë të punësuar.	0
Në përgjithësi ka qenë mirë vetëm të kishte qenë me i gjatë orari ditorë.	Mendoj që do të kryej një kurs dhe të aftësohem që të jem e gatshme të punoj dhe të aftësohem në hyrje në Kuzhinieri.	Çdo gjë ka qenë e mirëkuptuar dhe e rregullt.
0	0	Çdo gjë ka qenë në nivel, përvojë e re në këtë Qendër.
Furnizimi me material ushqimorë në mënyrë me të rregullt që kandidati të mos mbetet pa material.	Po	Krejt në nivel trajnimi.
Të gjitha janë shkëlqyeshëm.	Ju kisha lutur ta vijoni këtë kurs, është mjaft profitabil.	Çdo gjë ishte përfekte.
0	0	Çdo gjë në rregull, përvojë e mirë.
Furnizimi me material ushqimorë të jetë më kualitativ, sidomos perimet.		0
0	0	Në përgjithësi, çdo gjë ishte në rregull
Çdo gjë në nivel.	Ju kisha ftuar të gjithë rininë që të merrni pjesë në kursin e kuzhinierisë sepse ja vlen dhe do të aftësohen për vete dhe do të punësohen më lehtë.	0
Çdo gjë në nivel.	Ju kisha preferuar të gjithë të rinjëve që të aplikojnë për kursin e kuzhinierisë sepse mundësitë për punësim janë më të mëdha.	Çdo gjë ka qenë në rregull.
Në përgjithësi ka qenë mirë vetëm të kishte qenë me i gjatë orari ditorë.		0
0	0	Çdo gjë ka qenë në rregull sa i

		përket neve qe punojmë.
Asnjë	Me vijuar kursin është fitimprurës.	Çdo gjë perfekte.
0	0	Shumë mirë ka qenë eksperiencë e re.
0	0	Kohëzgjatja e kursit të jetë më e gjatë
Asgjë		Çdo gjë në rregull.
0	0	Sa i përket Qendrës për Aftësim (QAP) çdo gjë ka qenë mirë si në trajnim edhe në përgjithësi në punët e kuzhinierisë.
Nuk kam ndonjë kritikë vetëm lëvdata		
Çdo gjë në nivel.		0 Vet fakti qe kam qenë duke punuar ka qenë në rregull.
0	0	Në përgjithësi ka qenë shumë mirë vetëm në furnizim me materiale hargjuese ka nevojë më shumë.
Përmirësimi i modulit të internetit	Sigurimi i transportit dhe ushqimi dhe libri.	Shtimi o moduleve, Auto cad.
Moduli i Internetit	Transporti, ushqimi.	Shtimi o moduleve, Web design, Vizatim Auto cad.
Moduli i Internetit të përmirësohet	Transporti, ushqimi.	Trajnime në Auto cad.
Fusha e IT duhet te përmirësohet.	Shpenzimet ditore, materiali trajnues.	Në fushën e IT duhet të pasurohet me shumë planprogrami, të futen gjuhët programuese, të cilat krijojnë më shumë mundësi për punësim siç janë: WEB Design, C++, Word Press, Adobe Photoshop.
Të zgjerohet më shumë plan programi dhe të kemi mundësi të mësojmë më shumë gjëra.	Shpenzimet ditore dhe materialet.	Përveç qe jam ndarë e kënaqur me trajnimin nuk kam ndonjë koment sa i përket sugjerimeve kisha pas dëshire të shtohen programet si C++ dhe shumë të tjera.
IT, Programim pse jo edhe ambienti i trajnimit.	Transporti, ushqimi, materiali i trajnimit.	Si trajnim ka qenë shumë i mirë dhe ka pas objekt pozitiv.
Shtimi i programeve të programimitnsi dhe menaxhimit të rrjeteve sociale. Ajo çfarë më kishte ndihmuar shumë mua personalisht si studente e Master do të me ndihmonte shumë trajnimi mbi programet SPSS mbi hulumtime.	Transporti, ushqimi, materiali i trajnimit.	Hapja e një mundësie për trajnim për programim SPSS dhe trajnim mbi fushën e hulumtimeve.
Si p.sh. Të rritet hapësira e klasës, të ketë module tjera.	Sadopak ti stimulonte kandidatët në vijimin e aftësimin profesional.	Gjatë aftësimin tim në këtë qendër çdo gjë ishte profesionale deh vetëm të vazhdoni me këtë profesionalizëm.
Mua do të më ndihmonte programi SPSS mbi hulumtime	Materiali trajnues, ushqimi	Hapja e një mundësie për trajnim për programim mbi SPSS
Fusha e IT duhet te përmirësohet.	Shpenzimet ditore dhe materiali trajnues.	Në fushën e IT duhet të pasurohet me shumë plan programi, të futen gjuhët programuese, të cilat krijojnë më shumë mundësi për punësim siç janë: WEB Design.
Në fushën e kompjuterit do te kisha shtuar më shumë ndryshime gjatë	Do te më stimulonte të vazhdoja aftësimin për shumë	Të shtohen me shumë programe për punësim me të lehtë ne të

trajnimin, p.sh. Puna në grup, me shumë module, programe tjera.	arsye gjetja e një pune të re, aftësimi profesional më i lartë etj.	ardhmen, si p.sh web design, Adobe, Photoshop etj.
Në tri fushat duhet të përmirësohet nga pak, unë ashtu mendoj me material dhe kompjuterë.	Materiali trajnues	Nuk kam.
Do të shtoja disa module të cilat do të jenë një dobi të kursantit, programet me të përdorura viteve të fundit.	Stimulimi me i mirë do të ishte nëse pas aftësimin të jetë i sigurt vendi i punës.	Sugjerimi im për fushën e IT do të ishte që të futen me shumë programuese Wb Design, Auto Cad, Adobe Photoshop.
Mendoj se duhet të shtohen edhe disa materiale për të trajnuar si p.sh. dizajn grafik, sigurim i rrjeteve.	Përgatitje për një vend të punës në të ardhmen, kjo do të më stimulonte të vazhdoj aftësimin.	Do të sugjeroja që ambienti i sallës të ishte më i ngrohtë pasiqe e kemi pak të vështirë të qëndrojmë në të ftohtë.
0	0	Në përgjithësi ka qenë mirë vetëm në furnizim të materialit harxhues ka pas nevojë më shumë.
0	0	Në përgjithësi ka qenë mirë vetëm në furnizim të materialit harxhues ka nevojë më shumë.
Duhet të shtohen edhe module tjera p.sh. Dizajni grafik, vizatim teknik etj.	Do të më stimulonte të vazhdoja aftësimin në rast se do të dorezohet ndonjë punë të jemi të gatshëm	Ambienti i brendshëm është i ftohtë dhe e kemi problem për të mësuar.
Fushat e IT duhet të përmirësohen.	Shpenzimet ditore, materiali trajnues.	Në fushën e IT duhet të pasurohet me shumë planprogram, të futen gjuhët programuese të cilat krijojnë më shumë mundësi për punësim, siç janë web design, C++, Word Press, Adobe Photoshop.
Ndoshta vetëm materialet (librat) të jenë pak me gjerësisht për arsye se teknologjia po zhvillohet çdo ditë e me qenë me në hap me të.	Nëse kisha me qenë në kushte të vështira ekonomike arsyeja pse kisha vazhduar aftësimin kish me qenë mundësia për punësim, pasi me vazhdimin e këtij kursi mund të gjejë punë.	Në këtë kurs është çdo gjë në mënyrë të duhur dhe e lehtë për tu kuptuar e me marrë mësim rreth programeve dhe mësimin që bëhet këtu.
Me pas siguri në rrjete me i studiuar më gjerësisht.	Për një punësim me të mirë.	Ka qenë çdo gjë në rregull në këtë lëmi.

QAP PEJA

Pyetja 9: Cilat fusha nga aftësimet profesionale duhet të përmirësohen	Pyetja 10: Nëse jetoni në kushte të vështira ekonomike, çka do t'ju stimulonte ta vazhdoni aftësimin?	Pyetja 11: Komente apo sugjerime tjera.
Kompjuterët duhet të jenë të rinjë	Kompensimi i mëditjeve	S'kam koment
